



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 756/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Burim Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Besart Ademi, duke vendosur lidhur me apelin e ushtruar nga Nuredin Ibishi kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.756/2021 i datës 05.03.2021, i ushtruar nga Nuredin Ibishi kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, i ushtruar kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet: 1841E/02D, 1840E/01D, 1844E/01D, 1839E/01R, 1828E/01D, 1827E/01R, 1825E/01D, 1823E/01R, 1823E/02D, 1817E/01R, 1817E/02D, 1822E/02D, 1821E/01D, 1814E/02R, 1814E/03D, 1807E/01R, 1807E/02R, 1807E/03D, 1806E/01D, 1801E/04R, 1802E/02R, 1802E/03R, 1801X/03D, 1808E/02D, 1815E/02D, 1820E/01R, 1824E/03R, 1824E/04R, 1824E/06R, 1824E/07R, 1824E/08R, 1824E/15D, 1827E/01R, 1833E/02D, 1834E/01R, 1836E/01D, 1830E/01R, 1830E/02D, 1802X/01R, 1802X/02R, 1802X/03D, 1804E/01R, 1804E/02D, 1805E/01D, 1842E/01D.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 05.03.2021, ka pranuar apelin Anr.756/2021 Nuredin Ibishi kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendon se sipas informatave të vëzhguesve të partis së tij dhe vëzhguesve të OJQ-ve se gjate procesit të numërimit dhe mbushjes së formularëve ka pasur manipulime në raport me votat e kandidatëve, e posaçërisht në votat e mija në Komunën e Pod/02D, 1840ujevës. Kërkon nga PZAP që mundësoj te behet rinumërimi i votave në këto vendvotime; : 1841E/02D, 1840E/01D, 1844E/01D, 1839E/01R, 1828E/01D, 1827E/01R, 1825E/01D, 1823E/01R, 1823E/02D,

1817E/01R,1817E 02D, 1822E/02D, 1821E/01D, 1814E/02R, 1814E/03D, 1807E/01R, 1807E/02R,1807E/ 03D, 1806E/01D, 1801E/04R, 1802E/02R,1802E/03R, 1801X/03D, 1808E/02D, 1815E/02D, 1820E/01R, 1824E/03R,1824E/ 04R,1824E/ 06R,1824E/07R,1824E/08R,1824E/15D, 1827E/01R, 1833E/02D, 1834E/01R, 1836E/01D, 1830E/01R,1830E/ 02D, 1802X/01R,1802X/ 02R,1802X/ 03D, 1804E/01R,1804E/ 02D, 1805E/01D, 1842E/01D.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit te provave te bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se me datë 05.03.2021 Nuredin Ibishi kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ka paraqitur apel Anr.756/2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet: 1841E/02D, 1840E/01D, 1844E/01D, 1839E/01R, 1828E/01D, 1827E/01R, 1825E/01D, 1823E/01R, 1823E/02D, 1817E/01R,1817E 02D, 1822E/02D, 1821E/01D, 1814E/02R, 1814E/03D, 1807E/01R, 1807E/02R,1807E/ 03D, 1806E/01D, 1801E/04R, 1802E/02R,1802E/03R, 1801X/03D, 1808E/02D, 1815E/02D, 1820E/01R, 1824E/03R,1824E/ 04R,1824E/ 06R,1824E/07R,1824E/08R,1824E/15D, 1827E/01R, 1833E/02D, 1834E/01R, 1836E/01D, 1830E/01R,1830E/ 02D, 1802X/01R,1802X/ 02R,1802X/ 03D, 1804E/01R,1804E/ 02D, 1805E/01D, 1842E/01D.

PZAP, pas shqyrtimit të apelit Anr.756/2021, provave të bashkangjitura në apel, erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Nuredin Ibishi kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e pretenduara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë vetem pretendime te tij sepse pritjet e ankuesit për të marrë sa më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka edhe mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar Nuredin Ibishi kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 756/2021 më datën 06.03.2021

Kryesues i Panelit
Zyhdi Haziri



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.